



MANDATI

- Institucion gjyqësor i përkohshëm
- Mandat dhe juridiksion mbi krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të parapara në legjislacionin e Kosovës, siç përcaktohet në nenin 15 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar
- Vetëm përgjegjësi penale individuale
- Krime të cilat pretendohet se janë kryer midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 në lidhje me pretendimet e paraqitura në raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës të vitit 2001
- Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë juridiksion mbi persona fizikë të cilët janë shtetas të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), ose mbi persona të akuzuar për kryerje krimesh kundër personave që janë shtetas të Kosovës/RFJ-së
- Dhomat e Specializuara të Kosovës mundësojnë pjesëmarrjen e viktimave në procedura

STRUKTURA

DHOMAT


KRYETARI, Gjykatëse Ekaterina Trendafilova



- Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë
- Sipas nevojës, Kryetarja cakton gjykatësit nga regjistri në një çështje gjyqësore, në përputhje me Rregulloren e Caktimit të Gjykatësve që është miratuar

ZYRA ADMINISTRATIVE

ADMINISTRATORI, dr. Fidelma Donlon



PUNONJËSIT

- Në përputhje me Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, në Dhomat e Specializuara të Kosovës punojnë punonjës dhe gjykatës ndërkombëtarë.
- Mund të aplikojnë shtetas të 27 shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të tjera kontribuuese (Kanada, Norvegji, Turqi, Shtetet e Bashkuara, Zvicër).

KRONOLOGJI E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

JANAR 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miraton një Raport me titull "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë".

SHTATOR 2011

Bashkimi Evropian formon Task Forcën Hetimore Speciale për hetimin penal të pretendimeve për krime lufte dhe krim të organizuar të paraqitura në Raportin e KiE-së.

PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me "dhoma të veçanta gjyqësore".

NËNTOR 2014

Formimi i Ekipit Planifikues për Gjykatën.

GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës, që shënon fillimin e punës së institucionit në Hagë.

SHTATOR 2016

David Schwendiman emërohet Prokuror i Specializuar.

DHJETOR 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e Dhomave të Specializuara dhe merr detyrën në janar 2017.

JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pranues, e cila përbën bazën ligjore që u mundëson Dhomave të Specializuara të Kosovës kryerjen e procedurave gjyqësore në Holandë.

SHKURT 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

MARS 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila i nënshtrohet shqyrtimit prej Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

QERSHOR 2017

Shqyrtimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave prej Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, për t'u mundësuar Dhomave të Specializuara të Kosovës kryerjen e procedurave penale.

MAJ 2018

Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës

SHTATOR 2018

Jack Smith pason David Schwendimanin në postin e Prokurorit të Specializuar.

QERSHOR 2019

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hyjnë në mjediset e tyre të reja.

SHKURT 2020

Prokurori i Specializuar njofton se ka ndërmend të fillojë procedime penale dhe Kryetarja Ekaterina Trendafilova cakton një gjykatës të procedurës paraprake për të shqyrtuar aktakuzat.

DOKUMENTE THEMELORE

- Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ("Shkëmbimi i Letrave") ratifikuar prej Kuvendit të Kosovës më 23 prill 2014
- Kushtetuta dhe Amendamenti Kushtetues, Neni 162: Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar – miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015
- Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar – miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015
- Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e Dhomave të Specializuara të Kosovës – siç është miratuar nga Plenarja e gjykatësve të Dhomave të Specializuara dhe shqyrtuar nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në qershor 2017